**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

# RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

| Eksperti Shqyrtues | Data e autorizimit të ekspertit | Date e dorëzimit të raportit | Nr. i lëndës |
|---|---|---|---|
| **Kreshnik Spahiu** | **06.10.2023** | **15.10.2023** | **2023/0756** |

## BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 02.10.2023, OE "Shkelqimi Invest SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me numër: 2023/0756, kundër njoftimit për kontratë dhe dokumenteve të tenderit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizimi, montimi dhe mirëmbajtja e klimave ne objekte administrative, arsimore dhe shëndetësore te Komunës se Ferizajt" me numër të prokurimit: "656-23-8880-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA FERIZAJ. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 250,000.00 €. Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

## DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

- Neni 1- Qëllimi - LPP
- Neni 7 - Ekonomiciteti dhe efikasiteti- LPP
- Neni 17.12 - Rregullorja e prokurimit publik
- Neni 17.15- Rregullorja e prokurimit publik
- Neni 4.3.c. -Rregullorja e prokurimit publik
- Neni 60 dhe neni 64.1 i LPP-se- afatet kohore te Kërkesës për rishqyrtim dhe Ankesës

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Parashtrojmë këtë Ankese kundër Njoftimit për kontrate te AK lidhur me procedurën: Furnizimi, montimi dhe mirembajtja e klimave ne objekte administrative, arsimore dhe

shendetesore te Komunes se Ferizajt. Ka shume paqartesi, qe kerkojme te rishqyrtohen, ti behen me te kuptueshme per OE qe jane te kesaj fushe, sepse per ne si njohes te fushes se klimatizimit disa nuk kan kuptim. AK keto pretendimet tona nuk i ka trajtuar ne detaje ashtu siq eshte bere kerkesa per rishqyrtim por vetem ne pergjithesi.

Pjesa e pare: AK ka bere shkelje te nenit 60 dhe 64.1 te LPP-se duke mos e shtyre afatin e dorezimit te tendereve per 10 dite pas Vendimit te kerkeses per rishqyrtim, kjo perben shkelje te rende dhe me paramendim sepse edhe pas verejtjes tone permes telefonit dhe ne sistem, zyrtarja e prokurimit pergjigjet qe meqenese e kemi refuzuar kerkesen per rishqyrtim nuk ka nevoje ta zgjatet afati.

Kjo eshte nje shkelje rende e zyres se prokurimit.

Pjesa e dyte: Kerkesa e kapacitetit ekonomik eshte shume e specifikuar dhe nuk lejon mundesine e ofertimit te OE sipas tregut te lire, edhe ligji i prokurimit e lejon mundesine e dorezimit te deshmive te ndryshme te kapacitetit ekonomik ndersa AK ka specifikuar vetem nje lloj deshmie qe e kufizon tregun e lire, Kerkojme ne kete faze te tenderimit lejimin e ofrimit edhe te deshmive tjera jo shume kufuzuese.

Kerkese tjeter eshte se OE duhet te ofroje se paku 2 saldues dhe 2 elektricist te certifikuar per siguri ne vendin e punes, konsiderojme se nuk eshte e nevojshme, fillimisht eshte hera e pare qe kërkohen saldues per nje kontrate per klima, aq me pak ata te kene certifikata te noterizuara dhe te jene te certifikuar per siguri ne pune. Ne kuader te 10 puntoreve qe AK ka kerkuar mund te kerkoj qe nje numer i caktuar te jene te certifikuar per siguri ne pune por jo te caktohet qe 2 saldues dhe 2 elektricist te jene te certifikuar sepse nuk perkon me natyren e kontrates.

Pastaj AK ka caktuar kerkesen: Lista e mjeteve te punes kamionet me shport 3 cope - ku njera per tyre te kete vinq me gjatesi min 25 m (me testim)., furgon per elektrik. Kjo kerkese eshte jashtzakonisht e rende dhe aspak nuk perkon me natyren e tenderit, pse duhet te jene te nevojshme 3 kamioneta me shporte dhe njera te kete vinq! Eshte pergjegjesi i OE fitues te beje montimin e klimave sipas mundesive te tij, qe shumicen e rasteve jane pozicione nga dritarja, nga ballkonet e shume rralle vjen rasti te behet montimi ne pjese ku duhet te angazhohet ndonje vinq.

Pjesa e trete: Kjo pjese ka te beje me disa paqartësi dhe njëherësh kërkesa për ndryshime te Përshkrimit te çmimit. Pjesa A, pozicioni 14 ka Përshkrimin e Furnizim me aparate për largimin e shpendeve nga shtyllat elektrike, kjo kerkese mund te jete urgjente por nuk perkon me natyren e ketij tenderi, nuk lidhet aspak me natyren e klimatizimi, si rrjedhoje e ketyre leshimeve edhe tek dosja jane kerkuar staf per elektricist ose saldues qe nuk i perkasin kesaj natyre. Pjesa B pozicioni 1 ka kete pershkrim Montim me mbajtes per klima, nuk eshte e qarte a eshte fjala vetem montimi i mbajtesve te klimave apo montimi i klimave bashk me mbajtes, sepse montimi i klimes eshte cekur edhe ne pjesen C pozicioni 12. Pjesa C, pozicioni nr.2 shkruan Mbushja me gas e klimave, dhe nuk ceket lloji i gazit. Pjesa C. pozicioni 3 deri ne 10, ka te beje me Mirmbajtje te gypave, kabllave etj por per ne eshte e paqarte qka mund te mirembahet aty! Kablla dhe gypat si pjese jane cekur tek furnizimi bashk me klima, nuk e dim qka nenkuptojne keto pozicione dhe kur mund te shfrytezihen. Pjesa C, pozicioni 14, perseri eshte mirmbajtja e aparatev per largimin e shpendeve siq e cekem me larte vetem se ketu eshte

mirmbajtje prandaj kerkojme largimin e ketij kriteri dhe pozicioni. Pastaj kontrata eshte kornize dhe kerkesa per klima te kohe pas kohshme me siguri dhe nuk besojme qe ka nevoje qe per nje dite te jene te angazhuar tri shporta per montim te klimave. Ne cdo rast eshte e mjaftueshme nje shport per ndonjë rast eventual dhe jo 3. OE duhet te kete kerkesen qe te jete i certifkuar per siguri dhe shendet ne pune, stafi i klimatizimit ka pervoje ne instalim te klimave prandaj kufizimi i kesaj kerkese eshte shume i quditshem. Ne fund te kesaj kerkese shkruan Furgon elektrik, edhe kjo kerkese eshte shume e quditshme, apo si kerkese ka mbetur nga ndonje dosje qe ka pasur te beje me qeshtje elektrike.

Perfundim: Te aprovohet Ankesa jone si e bazuar ne cdo pretendim te saj, behet korigjimi i procedures, konsiderojem se ne kete shpallje jane bere leshime qe s duhet te behen, ne dosja ka kritere te panevojshme ndersa ne paramase ka shume paqartesi si dhe pozicione qe sjane aspak te natyres se klimatizimit. KJo edhe nese eshte leshim teknik e zvoglon konkurrences e lire dhe te OE njohes te kesja fushe.

AK perveq qe ka bere leshime gjate pergagtitjet se procedures leshime ka bere edhe gjate trajtimit te Kerkeses per rishqyrtim duke mos e trajtuar ne detaje dhe duke mos e përfill legjislacionin prima dhe sekondar per shtyrje te afatit 10 dite pas Vendimit te kerkeses per rishqyrtim dhe kete me paramendim.

Operatori ekonomik duhet te ofroj deshmi se ka staf minimum 10 punetore Lista e stafit origjinal e vulosur dhe e neneshkruar nga operatori ekonomik te deshmuar me kontrata ose marreveshje mbi angazhim.

OE duhet te ofroje se paku 2 saldues dhe 2 elektricist te certifikuar per siguri ne vendin e punes OE duhet te ofroje te gjitha qertifikatat e punetoreve te noterizuara ne origjinalKontrata te punes ose marreveshje mbi angazhim

Inxhinier i diplomuar i elektros (ose master) .Një inxhinier i diplomuar elektros (ose master) , të argumentuar me diplomë universitare (kopje të vërtetuar–origjinal) dhe kontratë të punës valide ose marreveshje mbi angazhim.

Lista e mjeteve te punes kamionet me shport 3 cope - ku njera per tyre te kete vinq me gjatesi min 25 m (me testim)., furgon per elektrik Lista e mjeteve të punës (e nenshkruar dhe e vulosur), operatori ekonomik per keto automjete duhet te ofroj listen e mjeteve te punes te nenshkruar dhe vulosur ne origjinal te deshmuar me Librezat e qarkullimit. Në rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet të ofroj marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët dhe e noterizuar

KRITERET PËR VLERËSIM

**<u>Kapaciteti ekonomik dhe financiar</u>**

**Kërkesa:**

Raporti auditimit dhe i pasqyrave të audituara nga një kompani e licencuar e auditimit me

reputacion për vitet (2020,2021 dhe 2022), ku kërkohet që qarkullimi i OE ose grupit të jetë jo më pak se 300,000.00 euro.

**Dëshmia e kërkuar dokumentare:**

Kopje të pasqyrave në të ardhura dhe raporteve të menaxhmentit të çertifikuara nga një kompani e licencuar e auditimit me reputacion për vitet (2020,2021 dhe 2022) (të bashkëngjitet kopja e noterizuar e licencës së Auditimit).ose Deklaratat e dorëzuara ne Administratën Tatimore te Kosovës.

**<u>Kapaciteti teknik dhe professional</u>**

**Kërkesat:**

Operatori ekonomik duhet te ofroj deshmi se ka staf minimum 10 punetore.

OE duhet te ofroje se paku 2 saldues dhe 2 elektricist te certifikuar per siguri ne vendin e punes.

Inxhinier i diplomuar i elektros (ose master).

Lista e mjeteve te punes kamionet me shport 3 cope - ku njera per tyre te kete vinq me gjatesi min 25 m (me testim)., furgon per elektrik.

**Dëshmia e kërkuar dokumentare:**

Lista e stafit origjinal e vulosur dhe e neneshkruar nga operatori ekonomik te deshmuar me kontrata ose marreveshje mbi angazhim.

OE duhet te ofroje te gjitha qertifikatat e punetoreve te noterizuara ne origjinal- Kontrata te punes ose marreveshje mbi angazhim.

Një inxhinier i diplomuar elektros (ose master), të argumentuar me diplomë universitare (kopje të vërtetuar–origjinal) dhe kontratë të punës valide ose marreveshje mbi angazhim.

Lista e mjeteve të punës (e nenshkruar dhe e vulosur), operatori ekonomik per keto automjete duhet te ofroj listen e mjeteve te punes te nenshkruar dhe vulosur ne origjinal te deshmuar me Librezat e qarkullimit. Në rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet të ofroj marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët dhe e noterizuar.

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

N/A

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

Eksperti me datë 8.10.2023 ka kërkuar informacionet shtesë nga AK si vijon:

Me qëllim të sqarimit të pretendimeve ankimore na duhen informata zyrtare nga Zyra e Prokurimit dhe njësia kërkuese për pyetjet/çështjet si vijon:

- Cila është arsyeja e përfshirjes së pozicionit 14- Furnizimi dhe montimi me aparate për largimin e shpendëve ne shtyllat e ndriçimit publik, në këtë aktivitet të prokurimit. Pse nuk është përfshirë qëllimi i këtij pozicioni në Deklaratë të Nevojave për Përcaktimin e Disponueshmërisë së Fondeve të aprovuar nga ZKA ( Kryetari i Komunës) ?
- A është ndonjëra nga kërkesat e kapacitetit teknik dhe professional e domosdoshme vetëm për shkak të pozicionit Furnizimi dhe montimi me aparate per largimin e shpendëve ne shtyllat e ndriçimit publik apo të gjitha kanë të bëjnë vetëm me klimat ?
- Në të kaluarën, në sa raste sipas vlerësimit të njësisë kërkuese ka patur nevojë për saldues në montimin e klimave ?
- Në sa raste (pozicione) sipas vlerësimit të njësisë kërkuese është i nevojshëm intervenimi me kamionetë me shportë për të montuar apo servisuar klima?
- Tek përshkrimi i çmimeve: ku është dallimi në mes të pozicionit tek pjesa B - 1. Montimi me mbajtës per klima dhe pozicionit tek pjesa C – 12. Zhvendosja, bartja dhe montimi i klimës.

AK me datë 10.10.2023 në përgjigje të kërkesës ka dërguar informacionet si vijon:

- Përfshirjen e pozicionit 14- Furnizimi dhe montimi me aparate për largimin e shpendëve ne shtyllat e ndriçimit publik, në këtë aktivitet të prokurimit e kemi bërë për shkak se është e nevojshme që momentin e instalimit të klimave të bëhet edhe instalimi I aparateve për largimin e shpendëve meqë në katet e sipërme të objekteve komunale vazhdueshëm kemi problem të kësaj natyre dhe e kemi parë të nevojshme ndërlidhjen e këtyre pozicioneve për faktin se shfrytëzohet makineri e njejtë dhe në mënyrë që mos të krijojmë kosto shtesë por të kemi kursim të buxhetit të Komunës.
- Këto pozicione janë të ndërlidhura bashkë dhe kapacitetit teknik dhe profesional është I domosdoshëm meqe përveq në objektet komunale kemi paraparë qe këto aparate të vendosen edhe nëpër sheshet ku është e nëvojshme për të shmangur ndotjet e shesheve nga shpendët dhe objektet tjera komunale meqë kemi problem të shumta nga këto ndotje që shkaktohen nga shpendët.
- Nevoja për saldim kemi pasur në të gjitha rastet e montimit të klimave, si dëshmi po u përcjellim edhe foto të objektit të Komunës.
- Intervenimi me kamionetë me shportë për të montuar apo servisuar klimat është I nevojshëm në të gjitha rastet e intervenimit për të gjitha objektet komunale meqë lartësia për tu arritur me shkallë nuk është e mundur dhe në të kaluarën implementimi I kontratës për vendosjen e klimave ka dështuar pikërisht për shkak të mungesës së këtij pozicioni.
- Pozicionit tek pjesa B - 1. Montimi me mbajtës per klima-nënkupton vendosjen dhe montimin e klimave të reja, kurse pjesa C – 12. Zhvendosja, bartja dhe montimi i klimës, nënkupton zhvendosjen, bartjen dhe montimin eventual të klimave të përdorura por që

| |
|---|
| është e nevojshme t'iu ndërrohet lokacioni. |

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

| |
|---|
| N/A |

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

| |
|---|
| N/A |

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

| |
|---|
| N/A |

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Shkelqimi Invest SH.P.K.**

**Sqarim hyrës**

Parashtruesi i ankesës ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së me datë 27.09.2023, për të cilën AK me 29.09.2023 ka marrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë me veprimet e AK-së në procedurë, kriteret e përzgjedhjes dhe dokumentin e paramasës. Në vijim janë përshkruar pretendimet, rrethanat e çështjes për secilin pretendim dhe vlerësimi i ekspertit bazuar në provat shkresore në procedurë.

**Përgjigje në pretendimin ankimor 1**

OE ankues pretendon se AK ka bere shkelje të nenit 60 dhe 64.1 te LPP-se duke mos e shtyre afatin e dorëzimit te tenderëve për 10 ditë pas vendimit për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.

OE ankues ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së me datë 27.09.2023, me pretendimet e njëjta ankimore sikurse në këtë ankesë.

AK me datë 27.09.2023 ka publikuar vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, me këshillën juridike për mundësinë e ankesës kundër vendimit në OSHP.

Në fillim, eksperti sqaron se OE ankues gabimisht i referohet neneve të LPP-së, pasi që nenet dhe përmbajtja të cilave ju referohet janë nenet e Rregullores 001/2022 për Prokurimin Publik (RrPP). Në lidhje me pjesën përmbajtësore të pretendimit, në nenin 63.1.1 pika b, të RrPP thuhet: "*Kurdo që refuzimi i kërkesës ndërlidhet me njoftimet për kontratë, dokumentet e*

*tenderit, Autoriteti kontraktues vazhdon më tutje me aktivitetin e prokurimit duke vlerësuar dhe konsideruar arsyet e refuzimit dhe rrethanat në të cilat ndodhet aktiviteti i prokurimit.*" Andaj, marrë për bazë faktin se kërkesa për rishqyrtim ndërlidhet me njoftimin për kontratë dhe dokumentet e tenderit si dhe vendimin e AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, AK ka vepruar në pajtim me nenin 63.1.1 të RrPP. Rrjedhimisht pretendimi ankimor në këtë pikë është i pabazuar.

**<u>Përgjigje në pretendimin ankimor 2</u>**

OE ankues pretendon se kërkesa e kapacitetit ekonomik është shume e specifikuar dhe nuk lejon mundësinë e ofertimit për faktin se AK ka specifikuar vetëm një lloj dëshmie qe e kufizon konkurrencën.

AK në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit ka specifikuar kërkesën për kapacitetin ekonomik dhe financiar si vijon: "*Raporti auditimit dhe i pasqyrave të audituara nga një kompani e licencuar e auditimit me reputacion për vitet (2020,2021 dhe 2022), ku kërkohet që qarkullimi i OE ose grupit të jetë jo më pak se 300,000.00 euro." Për këtë kërkesë si dëshmi dokumentare është kërkuar: " Kopje të pasqyrave në të ardhura dhe raporteve të menaxhmentit të çertifikuara nga një kompani e licencuar e auditimit me reputacion për vitet (2020,2021 dhe 2022)(të bashkëngjitet kopja e noterizuar e licencës së Auditimit).ose Deklaratat e dorëzuara ne Administratën Tatimore te Kosovës* "

Në lidhje me kërkesën mbi gjendjen ekonomike dhe financiare, në nenin 68, paragrafi 1, të LPP-së, përcaktohet […] *në përgjithësi, operatorëve ekonomik u lejohet të plotësojnë këtë kërkesë duke paraqitur, nëse është me rëndësi dhe e nevojshme, një ose më shumë nga referencat e dhëna në vijim:*

*1.1. raportin ose raportet përkatëse nga një ose më shumë banka;*

*1.2. evidencë të një police të sigurimit të lëshuar nga një kompani e njohur e licencuar e sigurimeve;*

*1.3. kopjet e certifikuara të një ose më shumë bilanceve të gjendjes ose ekstrakteve nga bilancet e gjendjes nëse kërkohet publikimi i bilanceve të tillë të gjendjes në kuadër të ligjit në vendin e themelimit të operatorit ekonomik; ose*

*1.4. kopjet e raporteve financiare dhe raporteve të menaxhimit të certifikuara nga një firmë e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur; ose*

*1.5. Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës"*

Eksperti sqaron se konform nenit të mësipërm, për përmbushjen kërkesës minimale të gjendjes ekonomike/financiare, OE-ve u lejohet që të dorëzojnë njërën nga dëshmitë dokumentare të nenit 68, paragrafi 1, andaj përcaktimi i vetëm dy referencave është në kundërshtim me dispozitën e sipërpërmendur. Rrjedhimisht pretendimi ankimor është i bazuar.

**<u>Përgjigje në pretendimin ankimor 3</u>**

OE ankues pretendon se kërkesat në lidhje me kapacitetin teknik dhe profesional që kanë të

bëjnë me stafin janë të panevojshme dhe shumës specifike që nuk përkojnë me aktivitetin.

AK në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit ka specifikuar kërkesat për kapacitetin teknik dhe profesional si vijon: "*Operatori ekonomik duhet te ofroj dëshmi se ka staf minimum 10 punëtorë" ; "OE duhet te ofroje se paku 2 saldues dhe 2 elektricist te certifikuar për siguri ne vendin e punës", "Inxhinier i diplomuar i elektros (ose master)*". Për të njëjtat kërkesa, dëshmitë dokumentare të kërkuar janë: "Lista e stafit origjinal e vulosur dhe e nënshkruar nga operatori ekonomik te deshmuar me kontrata ose marreveshje mbi angazhim." ; "*OE duhet te ofroje te gjitha qertifikatat e punetoreve te noterizuara ne origjinal- Kontrata te punës ose marreveshje mbi angazhim" ; "Një inxhinier i diplomuar elektros (ose master), të argumentuar me diplomë universitare (kopje të vërtetuar–origjinal) dhe kontratë të punës valide ose marreveshje mbi angazhim*".

Me qëllim të sqarimit të këtij pretendimi eksperti ka pyetur AK-në: në të kaluarën, në sa raste ka patur nevojë për saldues në montimin e klimave. Në përgjigjen e dhënë nga AK thuhet se nevoja për saldim kemi pasur në të gjitha rastet e montimit të klimave më parë në objektin e Komunës. Andaj, eksperti konsideron se bazuar në vlerësimin e nevojave të AK-së është e arsyeshme kërkesa për saldues në këtë aktivitet, rrjedhimisht në këtë pikë pretendimi ankimor është i pabazuar. Ndërsa, për pjesën ku kërkohet që 2 saldues dhe 2 elektricist te jenë të certifikuar për siguri ne vendin e punës, eksperti sqaron se përcaktimi i masave për përmirësimin e shkallës së sigurisë dhe shëndetit të të punësuarve në punë është kërkesë që përcaktohet me Ligjin Ligji Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, ku në nenin 9, paragrafi 1 përcaktohet që çdo punëdhënës është i detyruar të ngarkojë një ose më shumë të punësuar, për të kryer aktivitete nga siguria dhe shëndeti në punë. Andaj, kërkesa që dy salduesit dhe elektricistet të jenë të certifikuar për siguri në vendin e punës nuk është proporcionale dhe mund të jetë diskriminuese për OE ankues dhe OE tjerë që shprehin interesim për të marrë pjesë në këtë aktivitet të prokurimit. Sipas sqarimit të mësipërm, pretendimi ankimor është i bazuar në këtë pikë.

**<u>Përgjigje në pretendimin ankimor 4</u>**

OE ankues pretendon se kërkesa e kapacitetit teknik dhe profesional për pajisjet (mjetet) është e ekzagjeruar dhe jo qartë e definuar.

AK në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit ka specifikuar kërkesat për kapacitetin teknik dhe profesional si vijon: "*Lista e mjeteve te punes kamionet me shport 3 cope - ku njera per tyre te kete vinq me gjatesi min 25 m (me testim)., furgon per elektrik.*" Për këtë kërkesë si dëshmi dokumentare është kërkuar: " *Lista e mjeteve të punës (e nenshkruar dhe e vulosur), operatori ekonomik për këto automjete duhet te ofroj listën e mjeteve te punës te nënshkruar dhe vulosur ne origjinal te deshmuar me Librezat e qarkullimit. Në rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet të ofroj marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët dhe e noterizuar*"

AK në përgjigjen e dhënë në lidhje me kërkesën për kamionetë me shportë, sqaron se intervenimi me kamionetë me shportë për të montuar apo servisuar klimat është i nevojshëm në të gjitha rastet e intervenimit për të gjitha objektet komunale meqë lartësia për tu arritur me shkallë nuk është e mundur dhe në të kaluarën implementimi i kontratës për vendosjen e

klimave ka dështuar pikërisht për shkak të mungesës së këtij pozicioni.

Eksperti, në lidhje me këtë pikë sqaron se konform nenit 51 të LPP-së, AK përcakton kriteret e përzgjedhjes që një OE duhet ti përmbushë për tu konsideruar si i kualifikuar, megjithatë kriteret e përzgjedhjes duhet të kufizohen vetëm në kriteret e nevojshme për të siguruar se OE që posedojnë aftësitë e nevojshme profesionale dhe teknike për ti përmbushur kushtet e kontratës përkatëse do të konsiderohen të kualifikuar për të marrë një kontratë. Megjithatë në nenin 69 të LPP-së, paragrafi 4 thuhet: *në procedurat që shpien në dhënien e kontratës publike në të cilën përfshihet sigurimi i shërbimeve, AK mund të kërkojë nga OE të sigurojnë të dhënat me të cilat dëshmohet aftësia e tyre për sigurimin e këtyre shërbimeve; në veçanti, të dhënat mund të kërkohen lidhur me shkathtësitë, efikasitetin, kapacitetin, përvojën dhe besueshmërinë. Të dhënat përkitazi me aftësitë teknike të OE-ve mund të parashtrohen përmes një ose më shumë mjeteve në vijim, sipas llojit, sasisë dhe qëllimit të shërbimeve që duhet të furnizohen: 4.5. raportin mbi mjetet, stabilimentet ose pajisjet teknike që janë në dispozicion të OE për realizimin e shërbimeve*. Në këtë kuptim, përcaktimi i AK-së për 3 kamionetë me shportë është jorpoporcionale me lëndën e kontratës, duke marrë parasysh rrethanat që në një kontratë kornizë në të cilën nuk janë definuar sasitë nuk mund të jetë e mundshme që në secilën ditë paraqitet nevoja për intervenim në tre lokacione të ndryshme. Ndërsa për pjesën e kërkesës "furgon per elektrik", formulimi i tillë është i paqartë dhe lejon mundësi të kuptimit ndryshme nga palët, si dhe kërkesa e tillë është e panevojshme marrë parasysh lëndën e kontratës dhe mundësinë e kryerjes së testimeve elektrike përmes pajiseve mobile (aparate dore). Andaj sipas sqarimit të mësipërm pretendimi ankimor në këtë pikë është i bazuar.

**<u>Përgjigje në pretendimin ankimor 5</u>**

OE ankues pretendon se përshkrimi i kërkesave në dokumentin e paramasës është i mangët, i përsëritur dhe se është futur pozicioni që nuk ka të bëjë me këtë aktivitet.

AK në dokumentin "Parallogaria e klimave" ka vendosur pozicionet që kërkohet të furnizohen apo shërbimet që janë të nevojshme në zbatimin e kontratës. Gjithsej janë 35 pozicione të vendosura në 3 pjesë me qëllim të peshimit të çmimeve. Në pjesën A ndër të tjera është paraqitur edhe pozicioni me numër rendor *14- Furnizimi dhe montimi me aparate për largimin e shpendëve ne shtyllat e ndriçimit publik me specifika te pajisjes: Forca e rrymes: 220V AC Qendrueshmeria 10 (dhjetë) vite, Forca e ultratingujve 120 dB, Temperatura e punes"-40 deri 60 (C°), Siperfaqja mbrojtese: rreth 400m²* . Poashtu në pjesën C është vendosur pozicioni *14- Mirëmbajtja e aparateve sikurse në pozicionin e sipërpërmendur*. Me qëllim të sqarimit të këtij pretendimi eksperti ka pyetur AK-në se cila është arsyeja e përfshirjes së pozicionit 14- Furnizimi dhe montimi me aparate për largimin e shpendëve ne shtyllat e ndriçimit publik, ne këtë aktivitet të prokurimit. Në përgjigjen e dhënë nga AK thuhet se përfshirja e këtij pozicioni ne këtë aktivitet te prokurimit është bërë për shkak se është e nevojshme që momentin e instalimit te klimave te bëhet edhe instalimi i aparateve për largimin e shpendëve meqë në katet e sipërme të objekteve komunale vazhdueshëm ka problem të kësaj natyre dhe e kemi parë të nevojshme ndërlidhjen e këtyre pozicioneve për faktin se shfrytëzohet makineri e njëjtë dhe në mënyrë që mos të krijojmë kosto shtesë por të kemi kursim të buxhetit të Komunës. Në lidhje me këtë pikë, eksperti sqaron se arsyetimi i dhënë nga AK tregon se nuk ka ndonjë lidhshmëri funksionale në mes të lëndës kryesore të këtij aktiviteti që është furnizim dhe mirëmbajtje me klima dhe pozicioneve për furnizim dhe mirëmbajtje të aparateve për shpend, megjithatë AK ka vendosur ti përfshijë me qëllim që fondet të përdoren në mënyrën më

ekonomike. Andaj, pretendimi në këtë pikë është i pabazuar.

Lidhur me paqartësitë e pozicioneve në formularin e çmimit, eksperti ka pyetur AK-në se ku është dallimi në mes të pozicionit tek pjesa B - 1. Montimi me mbajtës për klima dhe pozicionit tek pjesa C – 12. Zhvendosja, bartja dhe montimi i klimës. AK është përgjigjur pozicionit tek pjesa B - 1. Montimi me mbajtës per klima-nënkupton vendosjen dhe montimin e klimave të reja, kurse pjesa C – 12. Zhvendosja, bartja dhe montimi i klimës, nënkupton zhvendosjen, bartjen dhe montimin eventual të klimave të përdorura por që është e nevojshme t'iu ndërrohet lokacioni. Në lidhje me këtë pikë, eksperti vëren se në pjesën A, AK ka vendosur pozicionin 5 Furnizim dhe montimi me Klime 24 inverter për ftohje dhe ngrohje, pra, në pozicion përveç furnizimit përfshihet edhe monitimi, ndërkaq sipas sqarimit të AK edhe në pjesën B, përkatësisht pozicioni 1 nënkupton montimin e klimave të reja. Në këtë rast ekziston rreziku i dëmtimit të buxhetit si shkak i duplifikimit të një shërbimi në me shumë se një pozicion. Më tej, në pjesën C tek pozicionet nga 2 deri në 10 nuk është i qartë shërbimi që duhet të kryhet, respektivisht nuk ceket lloji i gazit dhe tek mirëmbajtja e kabllove dhe sensorit nuk është e qartë a përfshihet zëvendësimi në rast të dëmtimi apo vetëm sanim. Rrjedhimisht pretendimi ankimor në këtë pikë është i bazuar.

Si përfundim eksperti sqaron se AK në këtë aktivitet të prokurimit ka përfshirë furnizimet dhe shërbimet për lëndën kryesore që janë klimat, si dhe ka përfshirë edhe furnizimin dhe mirëmbajtjen e aparateve për largimin e shpendëve që nuk janë të ndërlidhura me klima. Megjithatë, AK duhet të kujdeset që përfshirja edhe e këtij pozicioni nuk duhet të jetë arsye për krijimin e rrethanave diskriminuese për OE-të, por duhet të kufizohet në kërkesa minimale që garantojnë përmbushjen e kontratës. Në këtë kuptim, eksperti rekomandon panelin shqyrtues që të obligojë AK-në të bëjë korrigjimet e nevojshme në dokumentet e tenderit, sipas sqarimeve të mësipërme.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA FERIZAJ**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **Shkelqimi Invest SH.P.K.**

REPUBLIKA E KOSOVËS ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI PRISHTINË/A REPUBLIKA KOSOVA

**Kreshnik Spahiu**